



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FINIQ

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:
“MIREMBAJTJE E OBJEKTEVE SHKOLLORE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45-Pune ndertimore

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.666.667 (nje milion e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar njesia e prokurimit prane autoritetit/entit kontraktor **Bashkia Finiq** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023,2024,2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit

41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Vertetim të lëshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Per plotesimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit). Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet që "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j", të pikës 2 të këtij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Keto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e shërbimeve të kontratës, të lëshuar nga Ministrisë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Licensë për zbatim punimesh në pikat:

NP 3	A	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile dhe industrial, veshje fasadash
NS 4	A	Punime rafiniture të muratues dhe të lidhura me to, rafinitur me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rafiniture të natyrës teknike ndertuese

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti /entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **8 (tete) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit.
- b.** Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentim: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje minimumi **1 (nje)** muaj nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 10 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. **629, datë 15.7.2015** “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriteret e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). (Ndryshuar me Vendimin 216, datë 13.04.2023).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Kamion vetëshkarkues me vlerë kapacitet mbajtës (mbi 5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
---	--------	---------------------

Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji 2000l	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrypa sigurimi	5 cope	Pronësi ose me qera
Kokore	5 cope	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmes se shpejte	3 cope	Pronësi ose me qera



Si dëshmi për plotësimin e kësaj pikë operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit. Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërtetonpronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- v. Fabrika duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendodhje jo më larg se 50 km nga objekti dhe e paisur me leje mjedisore. Pra fabrika duhet të jetë aktualisht e montuar dhe në gjendje pune dhe me leje mjedisore për këtë vendodhje. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe planvendosja edhe fotografi të fabrikës në vendodhjen aktuale brenda kritereve.

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Per fabriken e asfaltit është kerkuar qe te kete distance 50 km nga vendodhja e objektit per faktin qe binderi dhe asfaltit te kene temperaturen e duhur gjate hedhjes ne objekt kjo ne bazë dhe të VKM 628 date 15.07.2015(Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve) . Ky objekt parashikohet te zbatohet ne stinen e dimrit dhe nisur nga faktorët atmosferik marja e asfaltit nga një distancë më e largët do të ndikonte në cilësinë dhe temperaturat optimale të nevojshme për hedhjen e tij në trupin e rrugës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar për çdo zë pune.

Grafiku i punimeve dhe afati përcaktuar janë pjesë e dokumentacionit të tenderit të hartuar dhe kontrolluar nga struktura teknike e posaçme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe *Specifikimet Teknike* për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë: **13.07.2026 Ora 10:00 në mënyrë elektronike** në www.app.gov.al.